

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 04.03.2022*

04.03.2022  
Ora 17:41

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së “Focus Media Group” për  
vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:      **Y. Merkaj, E. Allushi, M. Koja**
- **Parti Politike:**      **S’ka**

**Z. I. Celibashi:** Atëherë në seancë kemi këto çështje për të shqyrtuar:

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së “Focus Media Group” për akreditim vëzhguesish për zgjedhjet e 6 marsit”;

Projektvendimi “Për një shtesë në vendimin nr. 87, datë 19.02.2022 për akreditim vëzhguesish, kërkuar nga Report TV”;

kemi shqyrtimin e kërkesës së Ambasadës së Malit të Zi, për akreditim vëzhguesish;  
kemi projektvendimin që lidhet me shqyrtimin e shkeljeve administrative të konstatuara nga raporti i monitorimit për moszbatim të vendimit nr. 105, datë 28.02.2022 dhe 106 dhe 107, të datës 01 mars 2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndaj Policisë Bashkiake Shkodër, për vendosje te materialit propagandistik të kandidatëve për kryetar bashkie të subjekteve zgjedhore “Shtëpia e Lirisë”, Partia Demokratike dhe Partia Socialiste;

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 04.03.2022*

projektvendim “Për konstatimin e shkeljes për vendosje të materialeve propagandistike në favor të subjektit zgjedhor, Partia Socialiste në Bashkinë e Rrogozhinës”;

dhe pika e gjashtë është projektvendimi “Për krijimin e Qendrës së Votimit të Posaçme dhe miratimin e sasisë së fletëve të votimit për Qendrën e Posaçme të Votimit nr. 2224/1 në KZAZ nr. 43, Bashkia Rrogozhinë.

Atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me kërkesën e “Focus Media Group” për akreditimin e vëzhguesve, në zgjedhjet e datës 6 Mars 2022.

Po, Ermina!

**Znj. E. Allushi:** “Focus Media Group” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 58 gazetarëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur nuk respekton afatin kohor të përcaktuar në pikën 11 të vendimit nr.2/2022, të Komisionit Rregullator. “Focus Media Group” është subjekti, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhjet e përcaktuara në nenin 6, pika 2 e Kodit Zgjedhor. Kërkesa e paraqitur nuk është dorëzuar brenda afatit procedural, të përcaktuar në pikën 11, të vendimit nr. 2/2022 të Komisionit Rregullator. Afatet në procedurat administrative janë me rëndësi të veçantë në krijimin, ose në humbjen e ndonjë të drejte të palës. Afati i përcaktuar në pikën 11, të vendimit nr.2/2022 të Komisionit Rregullator, i cili përcakton se kërkesat e vëzhguesve shqiptarë për akreditim, i paraqiten Komisionit Qendror të Zgjedhjeve jo më vonë se data 18 shkurt 2022, paraqet një interval të caktuar kohor brenda të cilit duhet të kryhen veprimet në procedurën administrative. Komisioni Rregullator në kuadër të zgjedhjeve të pjesshme ka arsyetuar dhe vendosur një afat të logjikshëm për palët kërkuese nga njëra anë, për realizimin e së drejtës së tyre të ligjshme për të pasur vëzhgues në zgjedhje dhe nga ana tjetër për

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 04.03.2022*

vetë administratën e KQZ-së për të kryer veprimet proceduriale përkatëse. Në çdo rast vendosja e këtij afati procedural konsideron garantimin e sigurisë juridike dhe standarteve të rëndësishme për një proces të rregullt zgjedhor. Në këtë kuptim arrihet në konkluzionin se afati i parashikuar në pikën 11, të vendimit nr. 2/2022, të Komisionit Rregullator nuk është afat prekluziv që të përbëjë kusht për refuzimin e kërkesës për moszbatimin tërësor të akreditimit të vëzhguesve. Për këtë kërkojmë akreditimin nga ana juaj.

**Z. I. Celibashi:** Në rregull, dakord, faleminderit! Atëherë për të njëjtat arsye që i kemi bërë dhe më përpara publike, do ta pranojmë kërkesën për akreditim të vëzhguesve, të gazetarëve të "Focus Media Group". Janë 58 gazetarë të kësaj medie, të cilët marrin statusin e vëzhguesit për zgjedhjet e datës 6 Mars 2022. Po, faleminderit!

**Vendim nr. 121**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 04.03.2022*

04.03.2022  
Ora 17:45

**RENDI I DITËS**

Projektvendim “Për një shtesë në vendimin nr. 87, datë 19.02.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për akreditimin e gazetarëve dhe operatorëve të “Report TV”, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:      **Y. Merkaj, E. Allushi, M. Koja**
- **Parti Politike:**      **S’ka**

**Z. I. Celibashi:** Pika tjetër e rendit të ditës. Kërkesë shtesë për akreditim të gazetarëve dhe operatorëve të “Report TV”. Përveç çështjes së afatit?

**Znj. E. Allushi:** Është një shtesë në vendimin nr. 87, të datës 19.02.2022. Pra, është një shtesë në kërkesën e parë që ata kanë bërë.

**Z. I. Celibashi:** Mirë atëherë miratojmë dhe kërkesën e Report TV për shtatë gazetarë, kërkesë për të shtuar numrin e gazetarëve dhe operatorëve si vëzhgues të këtyre zgjedhjeve. Janë shtatë gazetarë dhe operatorë të Report TV. Miratohet edhe ky projektvendim.

**Vendim nr. 122**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 04.03.2022*

04.03.2022  
Ora 17:46

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së Ambasadës të Malit të Zi për  
vëzhgimin e zgjedhjeve të pjeshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:    **Y. Merkaj, E. Allushi, M. Koja**
- **Parti Politike:**    **S’ka**


*Z. I. Celibashi:* Atëherë, kërkesa e Ambasadës së Malit të Zi.

*Znj. E. Allushi:* Po, Ambasada e Malit të Zi ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e një vëzhguesi dhe zonën e vëzhgimit. Respekton afatin kohor dhe dokumentacioni është i plotë.

*Z. I. Celibashi:* Dakord! Mirë, atëherë miratojmë edhe kërkesën e Ambasadës së Malit të Zi, për të akredituar një vëzhgues afatshkurtër për zgjedhjet e datës 6 Mars 2022.

**Vendim nr. 123**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



04.03.2022  
Ora 17:46

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për shqyrtimin e shkeljeve të konstatuara nga raportimi i monitorimit, për moszbatim të vendimit nr. 105 datë 28 shkurt 2022 dhe 106 e 107 datë 1 Mars 2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndaj Policisë Bashkiake Shkodër”.*


**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:      **Y. Merkaj, E. Allushi, M. Koja**
- **Parti Politike:**      **S’ka**

**Z. I. Celibashi:** Kemi projektvendimin që lidhet me shkeljet administrative në Shkodër të fushatës zgjedhore, nga subjektet zgjedhore “Shtëpia e Lirisë”, Partia Demokratike dhe Partia Socialiste e Shqipërisë. Sekretari ose drejtoresha, kush do ta referojë këtë?

**Znj. M. Koja:** Monitoruesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka riparaqitur raportin e monitorimit për zbatimin e tre vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për heqjen e materialeve propagandistike nga vende të ndaluara në disa fasada banimi, në Bashkinë Shkodër. Referuar raportit të dërguar më datën 4 mars, konstatohet se Policia Bashkiake Shkodër nuk ka marrë masat për heqjen e materialeve propagandistike dhe mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e Policisë

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 04.03.2022*

Bashkiake Shkodër përbën shkelje të Kodit Zgjedhor dhe propozojmë marrjen e masës administrative ndaj Policisë Bashkiake Shkodër, Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit, atëherë flitet për materiale propagandistike të tre subjekteve zgjedhore, Partisë Socialiste, Shtëpia e Lirisë dhe Partisë Demokratike, edhe pse KQZ ka disponuar me vendim për t'i hequr këto materiale propagandistike, të cilat janë vendosur në ndërtesa publike, apo jo?

**Znj. M. Koja:** Jo vetëm. I është bërë dhe shkresë vetë subjekteve zgjedhore për të vepruar ata vetë, kryesisht pikësëpari. Më pas, duke qenë se ata nuk kanë reflektuar, me vendimmarrje Komisioneri i është drejtuar policisë bashkiake, e cila nuk ka vepruar në këtë rast.

**Z. I. Celibashi:** Po, dakord! Mirë, faleminderit, atëherë bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh” “f” dhe “n”, pika 2 e këtij neni, dhe nenet 79, pika 1, neni 92/ 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si dhe nenit 60 e vijues të ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror, vendos:

-Sanksionin administrativ me gjobë ndaj Policisë Bashkiake Shkodër në masën e 50 mijë lekëve.

-Ky vendim përbën titull ekzekutiv.

-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

-Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 orëve nga shpallja e tij në KAS.

**Vendim nr. 124**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 04.03.2022*

04.03.2022  
Ora 17:49

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për konstatimin e shkeljes për vendosje të materialeve propagandistike në favor të subjektit zgjedhor, Partia Socialiste në Bashkinë e Rrogozhinës”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:      **Y. Merkaj, E. Allushi, M. Koja**
- **Parti Politike:**      **S’ka**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me projektvendim “Për konstatimin e shkeljes për vendosje të materialeve propagandistike në favor të subjektit zgjedhor, Partia Socialiste në Bashkinë e Rrogozhinës”.

**Znj. M. Koja:** Atëherë kemi pasur dhe një konstatim të një shkeljeje në lidhje po me materialet propagandistike të vendosura në vende të ndaluara në Bashkinë Rrogozhinë. Sot ka dërguar një raport, tani pak para kësaj seance publike. Do të kërkonim që ta shtynim shqyrtimin për të marrë të dhëna më të sakta nga ana e monitoruesit, nëse është e mundur.

**Z. I. Celibashi:** Dakord! Këtë e shtyjmë për nesër paradite. Do të vendosim për orën më vonë, pasi të marrim dhe materialin e monitoruesit në lidhje me atë nëse e kanë ekzekutuar urdhrin e Komisionerit Shtetëror për të hequr materialin propagandistik nga fasada e objekteve publike.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





04.03.2022  
Ora 17:50

**RENDI I DITËS**

Projektvendim "Për krijimin e KOV-së së posaçme dhe sasinë e fletëve të votimit për qendrën e posaçme të votimit nr. 2224/1, në KZAZ nr.43, Bashkia Rrogozhinë".

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:      **Y. Merkaj, E. Allushi, M. Koja**
- **Parti Politike:**      **S'ka**

**Z. I. Celibashi:** Atëherë vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës, për krijimin e qendrës së votimit të posaçme.

**Z. Y. Merkaj:** Neni 43 i Kodit Zgjedhor përcakton se KZAZ-ja në përputhje me këtë Kod dhe me udhëzimin e KQZ-së, i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve krijimin e QV-ve të posaçme, në institucionet e posaçme. Këto komisione kanë të njejtën përbërje dhe të njejtën përgjegjësi si dhe Komisioni i Qendrës së Votimit. Referuar në këtë dispozitë ligjore, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 43, Bashkia Rrogozhinë, me shkresën nr. 1405, protokoli, datë 03.03.2022, i propozon Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve krijimin e Komisionit të Qendrës së Votimit të Posaçme nr. 2224/1, me adresë pranë Institucionit të Ekzekutimit të Veprave Penale Rrogozhinë. Nga ana e juristit të Institucionit të Ekzekutimit të Veprave Penale Rrogozhinë është bërë një kërkesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor

Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 04.03.2022*

Kavajë, për lejimin e të burgosurve që janë në këtë institucion që të votojnë. Deri më sot janë marrë 32 vendime nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Pritet që dhe nesër të merren 15 vendime të tjera. Kështu që plotëson dhe kriterin e përcaktuar në nenin 62, pika 2 të Kodit Zgjedhor, ku janë mbi 15 zgjedhës në këtë qendër votimi. Për këto arsye i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve krijimin e Qendrës së Posaçme të Votimit, me Nr. 2224/1 në Institucionin e Ekzekutimit të Veprave Penale Rrogozhinë, gjithashtu të merren masa dhe për sigurinë e fletëve të votimit dhe për vulën e kësaj qendre votimi. Ju faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Vendimi i KZAZ-së është marrë me konsensusin e të gjithë anëtarëve, të gjithë anëtarët?

**Z. Y. Merkaj:** Po, të gjithë anëtarët kanë propozuar!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, dakord! Atëherë e miratojmë propozimin e KZAZ nr. 43 duke autorizuar KZAZ nr. 43, Bashkia Rrogozhinë, që me vendim të krijojë dhe të emërojë Komisionin e Qendrës së Votimit të Posaçme me nr. 2224/1; të autorizojë KZAZ-në 43, Bashkia Rrogozhinë të marrë nga 20 fletë votimi nga qendra e votimit me nr. 2225, qendra e votimit nr. 2226 dhe qendra e votimit nr. 2226/1 dhe t'i dorëzojë në KQV nr. 2224/1, në total do të merren 60 fletë votimi për ta pajisur këtë qendër votimi; KZAZ-ja nr. 43 do të marrë masat që qendra nr. 2224/1 të pajiset me fletët e votimit nga qendrat e votimit të cituara në pikën 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 04.03.2022*

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24-orëve nga shpallja e tij në KAS. Faleminderit!

Kemi çështje të tjera në rendin e ditës? Nuk kemi! Mirë seanca mbyllet, faleminderit!

**Vendim nr. 125**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

